



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER NDRIÇIM D. CANI
ADRESA NAIM FRASHERI
TEL: 682012064



VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 2016

Nr. koleksioni: 726

Bulqize më 21/10/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021051660076057843

DATE 21/10/2021

NR REP 2016

NR KOL 726



A2021051660076057843

LËSHIMI I DËSHMISË

SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, më datë 21/10/2021, para meje Noter NDRIÇIM D. CANI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Bulqize, NAIM FRASHERI, u paraqit personalisht:

KËRKUESE:

Bedrije Manjani, atësia Suri, amësia Xhemile, shtetase Shqiptare, lindur në Kllobçisht, Dibër dhe banues në TIRANË, me adresë Donika Kastrioti; Nd. 6; H. 1; Ap. 42; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 15/02/1972, gjendja civile “e ve”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037043769 dhe nr. personal H25215011A

OBJEKTI: Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Luan Manjan**

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noteri kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë, përkatësisht Noter NDRIÇIM D. CANI, me zyrë Noterie në Bulqize, NAIM FRASHERI, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

VËREJ SE:

Në studion time noteriale kërkuesja **Bedrije Manjani** që është bashkëshortja e të ndjerit ka kërkuar lëshimin e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Luan Manjani me qëllim që të përfitojë nga e drejta e trashëgimisë. Ajo legjitimohet për të paraqitur kërkesën për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore.

Pas paraqitjes së kërkesës nga kërkuesja, unë noteri i kam dërguar Dhomës Kombëtare të Noterisë kërkesë, nese trashëgimlënësi ka lënë testament ose për të është lëshuar dëshmi trashëgi mie ligjore.

Dhoma Kombëtare e Noterisë ka kthyer pergjigje se: “për trashëgimlënësin nuk është lëshuar dëshmi trashëgimie ligjore, apo trashëgimlënësi të ketë lënë testament pranë ndonjë noteri”, prandaj unë noteri procedoj me lëshimin e trashëgimisë ligjore për të ndjerin Luan Manjani.

Unë noteri i njësisë vendore bashkia Bulqizë, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga kërkuesja, konstatoj se studioja ime noteriale, ka kompetencën tokësore për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin Luan Manjani, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit, rezultojnë të ketë qenë lagjia “e Re”, nd.4, Bulqize, bashkia Bulqizë, rrethi Bulqizë.

Në lidhje me pretendimin e kërkueses, para noterit, u shtruan për zgjidhje këto çështje:

1. Përcaktimi i trashëgimtarëve të trashëgimlënësit,

2. Pjesët takuese të secilit prej tyre.

Në referim të nenit 318 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili në lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit dhe pjesët takuese të tyre, bën të zbatueshëm ligjin e kohës së çeljes së trashëgimisë, referuar rregullimit ligjor në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga verifikimi i akteve provohet se trashëgimlënësi Luan Manjani i biri i Bilalit dhe i Dijes, mashkull, i datelindjes 08.05.1959, lindur në Shupenzë, Dibër, me gjendje civile i martuar, me shtetesi shqiptare, vendbanimi i fundit i të cilit ka qenë lagjia “e Re”, Bulqize, bashkia Bulqizë, e rrethit Bulqizë, ka vdekur me date 07-09-2021, në institucion mjekësor, nga IAM.

Ky fakt vertetohet nga çertifikata e vdekjes lëshuar me date 15.10.2021.

Nga verifikimet e bera nga Dhoma Kombëtare e Noterisë rezultojnë se i ndjeri nuk ka lënë testament, prandaj për pasurinë e tij do të lëshohet trashëgimia ligjore.



A2021051660076057843

Nga çertifikatat e paraqitura, vërtetohet se trashëgimlënësi ka qene i martuar me shtetasen Bedrije Manjani (Islami) e bija e Suriut dhe e Xhemiles, e datelindjes 15.02.1972, lindur në Kllobçisht, Diber, me gjendje civile e ve, banuese ne "Donika Kastrioti" nd.6;h.1;ap.4, njesia administrative 5, Tirane, bashkia Tirane, me numer personal H25215011A.

Nga martesat midis tyre ata kane lindur femijet:

1. **Ana Manjani** e bija e Luanit dhe e Bedrijes, femër, e datelindjes 14.07.1999, lindur në Bulqize, me gjendje civile beqare, me shtetesi shqiptare, e cila banon ne ne "Donika Kastrioti" nd.6; h.1; ap.4, njesia administrative 5, Tirane, bashkia Tirane, me numer personal J95714006G.
2. **Dije Manjani** e bija e Luanit dhe e Bedrijes, femër, e datelindjes 11.09.2000, lindur në Bulqize, me gjendje civile beqare, me shtetesi shqiptare, e cila banon ne ne , "Donika Kastrioti" nd.6;h.1; ap.4, njesia administrative 5, Tirane, bashkia Tirane, me numer personal K05911006M.
3. **Ema Manjani** e bija e Luanit dhe e Bedrijes, femër, e datelindjes 05.06.2004, lindur në Bulqize, me gjendje civile beqare, me shtetesi shqiptare, e cila banon ne ne "Donika Kastrioti" nd.6;h.1; ap.4, njesia administrative 5, Tirane, bashkia Tirane, me numer personal K45605008Q.
4. **Iva Manjani** e bija e Luanit dhe e Bedrijes, femër, e datelindjes 08.07.2011, lindur në Bulqize, me gjendje civile beqare, me shtetesi shqiptare, e cila banon ne ne "Donika Kastrioti" nd.6;h.1; ap.4, njesia administrative 5, Tirane, bashkia Tirane, me numer personal L15708040T.

Nga të gjitha çertifikatat e lindjes së fëmijëve dhe bashkëshortes së trashëgimlënësit të administruara, rezulton se të gjithë kanë qenë gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit. Kështu që në rrethin e trashëgimtarëve të radhës së parë të tij do të përfshihen femijet: Ana Manjani, Dije Manjani, Ema Manjani, Iva Manjani dhe bashkeshortja Bedrije Manjani.

Nuk vërtetohet që trashëgimtarët e përmendur me lart të jenë bërë të padenjë për të trashëguar trashëgimlënësin apo të jenë përjashtuar nga ai, gjithashtu nuk vërtetohet që ata të kenë hequr dorë nga e drejta e trashëgimisë.

Gjithashtu nuk vërtetohet që trashëgimlënësi të ketë patur fëmijë të tjerë të lindur jashtë martese, apo të birësuar.

Trashëgimlënësi Luan Manjani nuk ka vënë në leg ose në barrë pasurinë e tij.

Këta trashëgimtarë përfitojnë pasurinë trashëgimore në mënyrë të barabartë nga 1/5 një të pestën pjesë, femijet dhe bashkeshortja.

Këta trashëgimtarë përfitojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga trashëgimia e trashëgimlënësit Luan Manjani.

Kërkesa e kërkueses Bedrije Manjani është e bazuar në ligj dhe në provat e paraqitura prandaj unë noter i njësisë vendore bashkia Bulqizë e pranoj atë.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për noterin";

V E N D O S A

1. Pranimin e kërkesës.

2. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Luan Manjani**, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë:

1. Ana	Manjani	(e bija e trashëgimlënësit 1/5 (një të pesten pjesë);
2. Dije	Manjani	(e bija e trashëgimlënësit 1/5 (një të pesten pjesë
3. Ema	Manjani	(e bija e trashëgimlënësit 1/5 (një të pesten pjesë
4. Iva	Manjani	(e bija e trashëgimlënësit 1/5 (një të pesten pjesë
5. Bedrije	Manjani	(bashkeshortja e trashëgimlënësit 1/5 (një të pesten pjesë)

të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga 1/5 (një të pestën) pjesë të pasurisë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënësit.

3. Kërkuesi mori dëgjimin dhe iu sqarua nga Noteri detyrimi ligjor për depozitim të dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë



A2021051660076057843

kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonese, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".

4. Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë in stitucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimtarët imlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 "Për Noterinë". Gjithashtu nëse trashëgimtarët imlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese.

Bashkëlidhur certifikata e martesës nr. 38/23, date 29/07/1999, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bulqize, date 15.10.2021, referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

5. Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkuases.

6. Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 3 (tre) fletë dhe lëshohet në kopje origjinale nga të cilët, njëri depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkuarit për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pasuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.

7. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

8. Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Bulqizë, sot më datë 21/10/2021



NOTER

NDRIÇIM D. CANI